




Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prilato Received/Delivry	31.12.2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMBSHCK	6469/2021		1/4



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.852/2021**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji** për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.825/2020 të datës 01.09.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.71/2020 të datës 06.03.2020 e parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë rruga “Mbretëresha Teuta” CIII/11, Komuna e Mitrovicës, kundër Vendimit me KZKA/02/2020 dhe me Nr.Prot:03/20 të datës 07.02.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 30.12.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

**Përfundon procedimi administrativ** i filluar ma ankesën me numër A.nr.71/2020 e datës 06.03.2020 e parashtruar nga ankuesja [redacted] për shkak që objekti i ankesës është bërë i pamundur.

**A r s y e t i m**

Me Vendimin me Nr. Proy:04/18 të datës 07.02.2018 të Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, ankuesja Luljeta Arifi e punësuar në pozitën Nëpunëse e Lartë për Koordinim Teknik, Informim dhe Marrëdhënie me publikun, ngarkohet me detyrat e Menaxherit të Personelit. Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore më datë 18.05.2019 ka shpallur konkursin e brendshëm-avancim për vendin e punës “Udhëheqës i Divizionit të Personelit dhe Shërbimeve të Përgjithshme” me numër të referencës RN00004888 pas marrjes së autorizimit për publikimin e konkursit të datës 17.05.2019 nga Ministria e Administratës Publike/Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil.

Ankuesja [redacted] ka aplikuar në konkursin e datës 18.05.2019 për vendin e punës “Udhëheqës i Divizionit të Personelit dhe Shërbimeve të Përgjithshme” me numër të referencës RN00004888 e cila pas përfundimit të procedurave të rekrutimit emërohet në pozitën “Udhëheqëse e Divizionit të Personelit dhe Shërbimeve të Përgjithshme” me çka i bëhet edhe ndryshim dhe plotësimi i akt emërimit i datës 01.07.2019.

Udhëheqësi Ekzekutiv i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore me datë 22.10.2019 ka nxjerr Vendim me Nr.Prot:26/19 me të cilin ka bërë shfuqizimin e vendimit të datës 07.02.2019 për detyrë shtesë si Menaxhere e Personelit. Ankuesja me datë 25.10.2019 ka parashtruar kërkesë tek Udhëheqësi Ekzekutiv për të shqyrtuar këtë proces pasi që me akt emërim mban pozitën Udhëheqësi i Divizionit të personelit dhe Shërbimeve të Përgjithshëm. Udhëheqësi Ekzekutiv më datë 29.10.2019 ka njoftuar ankuesen që ajo si menaxhere e personaliet më datë 15.05.2019 ka hartuar përshkrimin e detyrave të punës të cilat nuk përputhen me detyrat dhe përgjegjësit e pozitë Udhëheqës i Divizionit për Shërbime të Përgjithshme, duke theksuar që pozita Udhëheqës i Divizionit të Personelit dhe Shërbimeve të Përbashkëta nuk ekziston si pozitë sepse nga Ministria e Administratës Publike është miratuar pozita Udhëheqës i Divizionit për Shërbime të Përgjithshme dhe duhet të bëhet plotësimi dhe ndryshimi i akt emërimit.

Më datës 21.11.2019 ankuesja kundër këtij vendimi ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, fillimisht nuk ka vendosur për ankesën e ankueses për arsye siç theksohet që me Aktvendimin e Gjykatës Kushtetues lidhur me Ligjin për Zyrtarët Publikë është krijuar paqartësi. Ministria e Administratës Publike më datë 10.01.2021 ka njoftuar institucionet e administratës shtetërore se kthehet në zbatim Ligji për Shërbimin Civil i Republikës së Kosovës deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese, atëherë Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, më datë 07.02.2020 ka nxjerr Vendim KZKA/02/2020 me Nr.Prot:03/20 me të cilin ka hedhë poshtë si të pabazuar ankesën e ankueses.

Pasa se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, ankuesja më datë 15.01.2020 ankuesja ka parashtruar ankesë me Nr.Prot: 89/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Ankuesja e pa kënaqur me Vendimin me numër KZKA/02/2020 të datës 07.02.2020 të Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, nëpërmjet e-mailit zyrtar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës [ankesa.kpmshek@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmshek@rks-gov.net), me datë 06.03.2020 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila regjistrohët me Nr. Prot: 606/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankueses, ndërsa më datë 15.05.2020, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesja ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative më datë 01.09.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.6825/2020 me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 15.05.2020 dhe duke e detyruar Këshillin e

Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda tridhjetë (30) ditësh të vendos për ankesën e ankueses.

**Kolegji për shqyrtimin e vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova:** Ankesën me Nr. Prot:606/2021 të datës 06.03.2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 06.03.2021 të ankueses; Vendimin KZKA/02/2020 të datës 07.02.2020 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore; Ankesën e datës 21.11.2019 të ankueses e parashtruar në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të KKTK-së; Vendimin e datës 22.10.2019 dhe 07.02.2018 të Udhëheqësit Ekzekutiv të KKTK-së; Shkresën e datës 15.05.2019; Miratimin nga Ministria e Administratës Publike i datës 17.05.2019 për Udhëheqës i Divizionit për Shërbime të Përbashkëta; Konkursin e datës 18.05.2019 për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Personelit dhe Shërbimeve të Përbashkëta; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i datës 01.07.2019; Organogramin e KKTK-së; Formularin e Planit Individual të Personelit i datës 05.11.2018; Kërkesën e datës 25.10.2019 të ankueses; Emailin e datës 29.10.2019 për ankuesen; Planin Individual të punës për periudhën korrik-dhjetor 2019 nga ankuesja; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 11.03.201; Përgjigje në ankesë e datës 16.03.2021; Njoftimin e datës 15.05.2020 për ankuesen nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimin A.nr.825/2020 të datës 01.09.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses [redacted] është e bërë i pamundur, *sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses të parashtruara përmes ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila konteston Vendimin me Nr. Port:26/19 të datës 22.10.2019 të Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore dhe Vendimin KZKA/02/2020 të datës 07.02.2020 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

Bazuar në të gjitha provat e lëndës, fillimisht ankuesja pozitën shtesë si Menaxhere e Personelit në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore, e ka marr në bazë të Vendimit të datës 07.02.2018 të Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, e cila pozitë nuk mund të ushtrohet për kohë të pacaktuar, sepse pozita shtesë është për një kohë të caktuar, për sa kohë vlerësohet nga Udhëheqësi me i Lartë Administrativ, rrjedhimisht meqenëse pozita Udhëheqës i Personelit dhe Shërbimeve të Përgjithshme është rekrutuar me konkurs, kanë pushuar të gjitha arsyet që ankuesja të ketë si detyrë shtesë pozitën Menaxhere Personeli, në këtë rast edhe është bërë shfuqizimi i vendimit të datës 07.02.2018 me Vendimin me Nr. Port:26/19 të datës 22.10.2019 të Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, në këtë rast Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson se meqë procedura e rekrutimit për pozitën Udhëheqës i Personelit dhe Shërbimeve të Përgjithshme është përfunduar dhe për këtë më datë 01.07.2019 ankueses i është bërë Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit, atëherë objekti për të cilin ka filluar procesi ankimor i ankueses kundër Vendimit me Nr. Port:26/19 e datës 22.10.2019 të Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, është bërë i pamundur apo i kotë, sepse me këtë rast nuk ka objekt shqyrtimi, rrjedhimisht në pajtim me dispozitat e nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: ***“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin***


*ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë*”, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bënë përfundimin e procedimit administrativ të iniciuar me ankesën e datës 06.03.2020 të ankueses.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me numër A.nr.852/2021**

**Avdyll BEKTESHI**

  
**Procesmbajtës**

**Malsore Gashi-BAJRAKTARI**

  
**Kryetare e Kolegjit**



**Vendimi i dërgohet**

- Ankueses [REDACTED]
- Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore;
- Menaxherit të Personelit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

